

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar
Financial Reporting

P5

Nr.

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 18.06.2016

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Abdyl sh.a bëri këto investime në ekuitet:

Me 1 prill 2015, bleu 12.8 milion aksione të zakonshme me vlerë nominale €1 nga gjithsej 16.0 milion të emetura të Naim sh.a nëpërmjet një këmbimi të tri aksioneve të Abdyl sh.a për pesë aksione në Naim sh.a, plus një pagesë në para prej €2 për aksion të Naim sh.a e pagueshme pas tre viteve. Çmimi i tregut të aksioneve të Abdyl sh.a me 1 prill 2015 ishte €4, dhe kosto e kapitalit të grupit në po të njejtën datë ishte vlerësuar 6% në vit.

Me 1 janar 2016, bleu 4.8 milion prej 12 milion aksioneve të zakonshme të Sami sh.a, duke paguar në para €3.40 për aksion.

Pasqyrat e të ardhyrave të veçanta të të tri kompanive për vitin e përfunduar me 31 mars 2016 janë dhënë më poshtë:

	Abdyl sh.a	Naim sh.a	Sami sh.a
	€'000	€'000	€'000
Të hyrat	84,000	49,600	40,000
Kosto e shitjeve	<u>(54,400)</u>	<u>(29,200)</u>	<u>(48,800)</u>
Bruto fitimi/(humbja)	29,600	20,400	(8,800)
Të hyrat tjera (shënim vi)	320	(0)	(0)
Kostot e shpërndarjes	(3,200)	(1,600)	(3,600)
Shpenzimet administrative	(6,000)	(5,600)	(6,800)
Kostot financiare	<u>(960)</u>	<u>(720)</u>	<u>(0)</u>
Fitimi/(humbja) para tatimit	19,760	12,480	<u>(19,200)</u>
Tatimi (shpenzim)/kreditim	<u>(6,960)</u>	<u>(2,080)</u>	<u>3,200</u>
Fitimi/(humbja) për periudhën	12,800	10,400	(16,000)

Ju janë dhënë edhe informatat në vijim:

- (i) Nuk ka pasur nevojë për korrigjime të vlerës së drejtë në datën e blerjes së Sami sh.a; përderisa tek Naim sh.a në datën e blerjes vlerat e drejta të Tokës, Fabrikës dhe Shpenzimeve të Zhvillimit tejkaluan vlerat e tyre në libra për €2.4 milion, €4.0 milion dhe €3.2 milion respektivisht.

Për më tepër, Fabrika kishte një jetë të përdorimit prej pesë viteve në datën e blerjes dhe Shpenzimet e Zhvillimit të cilat u kualifikuan si pasuri e paprekshme jo-qarkulluese ishin ende në zhvillim. Naim sh.a ende nuk i ka përfshirë këto vlera të drejta në pasqyrat e saj financiare dhe menaxhmenti ka këshilluar që zhvlerësimi i fabrikës të përfshihet në kosto të shitjeve.

- (ii) Fitimet e mbajtura të Naim sh.a dhe Sami sh.a me 1 prill 2015 ishin €14.4 milion dhe €28.0 milion respektivisht.
- (iii) Gjatë vitit Abdyl sh.a shiti mallra tek Naim sh.a me një çmim prej €14.4 milion, duke bërë një fitim prej 25% mbi kosto. Me 31 mars 2016, €6 milion (sipas çmimit të shitjes) nga këto mallra ishin ende në stoke të Naim sh.a.

- (iv) Të hyrat tjera në pasqyrën e të ardhurave të Abdyl sh.a paraqet dividendat e pranuar nga Naim sh.a me 30 prill 2016.
- (v) Supozoni që fitimet dhe humbjet e kompanive më sipër ndodhin njetrajtësisht gjatë vitit.
- (vi) Me 31 mars 2016, janë kryer testet e dëmtimit për Naim sh.a dhe Sami sh.a. Në atë datë, është ardhur në perfundim që zëri i mirë i degës të shlyhet për 20% të vlerës së drejtë në datën e blerjes, përderisa investimet në shoqëri duhet të jenë të barabarta me €14 milion, për shkak të humbjeve të vazhdueshme të shoqërisë që nga blerja e saj.
- (vii) Vlera e tanishme e €1 të arketueshme pas tre viteve me normë skontimi prej 6% është €0.840

Kërkohet:

- (a) Llogarit zërin e mirë në blerjen e Naim sh.a me 1 prill 2015, duke supozuar që është politikë e grupit të vlerësoj zërin e mirë sipas pjesës proporcionale. (5 pikë)
- (b) Përgadit Pasqyrën e Konsoliduar të të Ardhurave të Grupit Abdyl për vitin e përfunduar me 31 mars 2016. (15 pikë)

(20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 1

1. a) Zëri i mirë

	€'000	€'000
Konsiderata e transferuar:		
Këmbimi i aksioneve ($12,800 \times 3/5 \times €4$)		30,720
Konsiderata e shtyrë ($12,800 \times €2 \times 0.840$)		<u>21,504</u>
		52,224
<i>Minus</i>		
Aksionet e ekuitetit	16,000	
Rezervat para blerjës	14,400	
Korrigjimet e vlerës së drejtë ($3,200 + 2,400 + 4,000$)	<u>9,600</u>	
	$40,000 \times 80\%$	<u>(32,000)</u>
		20,224

b) Grupi Abdyl

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 mars 2016

	€'000
Të hyrat ($84,000 + 49,600 - 14,400$ ndër grupore)	119,200
Kosto e shitjeve (shih llogaritjet)	<u>(71,200)</u>
Fitimi bruto	48,000
Kostot e Shpërndarjës ($3,200 + 1,600$)	(4,800)
Shpenzimet Administrative ($6,000 + 5,600$)	(11,600)
Kostot Financiare ($960 + 720$)	(1,680)
Humbjet nga dëmtimi:	
Zëri i mirë [$20\% \times 20,224$ – shih pjesën (a)]	(4,045)
Investimet në shoqëri ($16,320 - 1,600 - 14,000$)	(720)
Pjesa e humbjeve nga shoqëria ($16,000 \times 40\% \times 3/12$)	<u>(1,600)</u>
Fitimi para tatimit	23,555
Tatimi ($6,960 + 2,080$)	<u>(9,040)</u>
Fitimi për periudhën	14,515
Atribuar:	
Mbajtësve të ekuitetit të prindit	12,595
Interesiave jo-kontrollues $\{(10,400 - 800 \text{ zhvlerësimi shtesë} \times 20\%)$	<u>1,920</u>
	14,515

Shënim: Dividenda prej Naim sh.a është eliminuar në konsolidim.

Llogaritjet e kostove të shitjeve:

	€'000
Abdyl sipas pyetjës	54,400
Naim sipas pyetjës	29,200
Blerjet ndër grupore	(14,400)
Zhvlerësimi shtesë në fabrikë ($4,000 \div 5$ vite)	800
Fitimi i përealizuar [$6,000 \times (25\% \div 125\%)$]	<u>1,200</u>
	71,200

Problemi 2

a) Rrokaqielli sh.p.k, një kompani e ndërtimit kontrakttoi disa projekte. Detajet e kontratave me 31 dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	Kontrata A	Kontrata B	Kontrata C
	€	€	€
Çmimi i kontratës	240,000	144,000	250,000
Kosto deri me datë	96,000	12,000	147,000
Kosto e vlerësuar deri në përfundim	96,000	108,000	63,000
Situacionet e faturuara dhe të arkëtuara	60,000	-	172,600
Data e fillimit	1 mars 2015	15 tetor 2015	1 qershor 2014
Data e vlerësuar e përfundimit	30 qershor 2016	15 shtator 2016	30 korrik 2016
Perqindja e kompletimit	?	?	?

Supozo që fitimet ndodhin njëtrajtësisht gjatë periudhës kontraktuese.

Në lidhje me kontratën C, pasqyrat e të ardhurave e vitit të kaluar tregonte të hyra €112,500 dhe shpenzime prej €94,500.

Metoda e përqindjes së kompletimit është e bazuar në metodën e koston. Kompania konsideron që rezultati i kontratës nuk mund të parashikohet me besueshmëri derisa kontrata të përfundohet se paku 25%. Në këto raste i njeh të hyrat në nivel të shpenzimeve që pritët të rikthehen

Kërkohet:

Llogarit shumat që duhet të përfshihen në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 dhe shumat e papaguara nga/(për) klientët lidhur me këto tri kontrata.
(7 pikë)

b) Gërmia sh.p.k huazoi €3 milion për të financuar ndërtimin e dy depove të vogla të cilat do të kërkojnë një vit për tu përfunduar. Puna filloi posa u mor kredia me 1 janar 2015. Me 1 tetor, 2015, Gërmia sh.p.k depozitoi €1.2 milion me një normë fikse të interesit prej 6% në vit, pasi ishte një shumë e kredisë që kishte mbetur e pashfrytëzuar që nga fillimi.

	Depo A	Depo B
	€	€
Depoziti më normë fikse (1 tetor 2015)	400,000	800,000
Kostot e ndërtimit të shkaktuara në 2015	600,000	1,200,000

Norma e interesit në kredi ishte 8%.

Kërkohet:

Llogarite koston që duhet të njihet në pasqyrën e pozitës financiare me 31 dhjetor 2015 për të dy depot.
(4 pikë)

c) Lidhur me SNK 36, *Dëmtimi i pasurive*, shpjego shkurtimisht termat në vijim:

- Dëmtimi;
- Njësia Gjeneruese e Parasë.

(3 pikë)

d) Prodhimi sh.a zhvillon një biznes të prodhimit dhe një nga njësitë e saj ka pasur rënie të mëdha të të hyrave për shkak të dështimit të teknologjisë së saj me 31 dhjetor 2015. Vlerat bartëse në vijim ishin në libra para dëmtimit:

	€ milion
Zëri i mirë	40
Teknologjia e prodhimit	10
Brendet	20
Toka	100
Ndërtesat	60
Pasuritë tjera neto	<u>80</u>
	310

Vlera e rikuperueshme e njësisë është vlerësuar €170 milion. Teknologjia e prodhimit është e pavlerë për shkak të dështimit të plotë. Vlerat në libra të pasurive tjera neto konsiderohen prezantime të arsyeshme të vlerave neto të realizueshme.

Kërkohet:

Diskuto si Prodhimi sh.a duhet të trajtoj dëmtimin më sipër.

(6 pikë)

Total (20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 2

2.

a)

Pasqyra e të ardhurave

	Kontrata A	Kontrata B	Kontrata C
	LI1	LI2	LI3
	€	€	€
Të hyrat	120,000	12,000	62,500
Shpenzimet	96,000	(12,000)	(52,500)
Fitimi/ (humbja) e njohur	24,000	-	10,000

Shumat bruto të papaguara nga (për) klientët

	Kontrata A	Kontrata B	Kontrata C
	€	€	€
Kostot deri me datë	96,000	12,000	147,000
Shto: Fitimin e njohur deri me datë	<u>24,000</u>		<u>28,000</u>
	120,000	12,000	175,000
Minus: Situacionet e faturuara	<u>(60,000)</u>		<u>(172,600)</u>
	60,000	12,000	2,400
Metoda e përqindjës së kompletimit	96,000	12,000	147,000
	192,000	120,000	210,000
	50%	10%	70%

Llogaritjet:

1. Kontrata A

Të hyrat 50% x 240,000	120,000
Shpenzimet 50% x (192,000)	96,000

2. Kontrata B

Të hyrat: Kostot e mundshme që do të rikuperohen	12,000
Shpenzimet: Të gjitha kostot e ngarkuara si shpenzime	12,000

3. Kontrata C

Të hyrat (70% x 250,000) - 112,500	62,500
Shpenzimet (70% x 210,000) - 94,500	<u>52,500</u>
Fitimi i vitit aktual	10,000
Fitimi për vitin 2010 112,500 - 94,500	<u>18,000</u>
Fitimi deri me tani	28,000

b)

	Depo A €	Depo B €
Kostot e huamarrjës së kapitalizuara		
1 janar deri me 31 dhjetor 2015		
€600,000/€1,200,000 x 8%	48,000	96,000
Minus: Të hyrat nga Investimet		
€400,000/€800,000 x 6% x 3/12	<u>(6,000)</u>	<u>(12,000)</u>
	42,000	84,000
Kosto e pasurive		
Kosot e shkaktuara	600,000	1,200,000
Kostot e huamarrjës së kapitalizuara	<u>42,000</u>	<u>84,000</u>
	642,000	1,284,000

c) Dëmtimi është zvogëlimi i vlerës së pasurisë për të siuruar që pasuritë nuk barten në shuma më të medha se vlerat e tyre të rikuperueshme (vlerën për biznesins).

Pasuria është e dëmtuar nëse shuma e rikuperueshme është nën vlerën aktualisht të treguar në pasqyrën e pozitës financiare.

Njesia gjeneruese e parasë (NjGjP) definohet si grupi më i vogël i pasurive të cilat gjenerojnë rrjedha të parasë të pavarura nga pasuritë tjera.

Nëse nuk është e mundur që të vlerësohet dëmtimi i pasurisë individuale sepse pasuria nuk gjeneron rrjedha të parasë veçmas, atëherë llogaritja e dëmtimit duhet të bazohet në NjGjP.

d)

Vlera bartëse është €310 milion

Vlera e rikuperueshme është €170 milion

Andaj kërkohet një dëmtim prej €140 milion

	Vlera bartëse € milion	Dëmtimi € milion	Vlera e dëmtimit € milion
Zëri i mirë	40	(40)	0
Teknologjia	10	(10)	0
Brendet	20	(10)	10
Toka	100	(50)	50
Ndërtesat	60	(30)	30
Tjera	<u>80</u>	<u>(0)</u>	<u>80</u>
NjGjP	310	(140)	170

Llogaritjet:

	€ milion
Total dëmtimi	140
Alokuar	
- Zëri i mirë	(40)
- Teknologjia	<u>(10)</u>
	90

Mbetur:

Proporcionalisht bazuar në vlerën bartëse:

$$\text{Brendet } 90 \times 20 / (20 + 100 + 60) = 10$$

$$\text{Toka } 90 \times 100 / (180) = 50$$

$$\text{Ndërtesat } 90 \times 60 / (180) = 30$$

Problemi 3

AXL sh.a planifikon të blejë 100% të aksioneve në Rose sh.a. Para dorëzimit të propozimit financiar, AXL sh.a është duke bërë një analizë të performancës financiare dhe operative të Rose sh.a. Drejtori financiar i AXL sh.a ka mbledhur informatat në vijim të cilat duke u bazuar në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015:

Shpjegim	Koeficientët e Rose sh.a	Koeficientët e Industrisë		
		Lartë	Ulët	Mesatar
Koeficientët e përformancës operative				
Fitimi bruto	29%	30%	20%	25%
Fitimi operativ	11%	15%	10%	13%
Kthimi në ekuitetin e aksionarve	9%	13%	7%	10%
Koeficientët e kapitalit qarkullues				
Koeficienti i qarkullimit	1.54 : 1	2 : 1	1 : 1	1.5 : 1
Ditët e qarkullimit të stoqeve	83 ditë	114 ditë	81 ditë	91 ditë
Mbledhja e të arkëtueshmeve	93 ditë	95 ditë	60 ditë	74 ditë
Koeficientët e leverazhit				
Koeficienti borxh/ekuitet	55 : 45	60 : 40	40 : 60	50 : 50
Mbulimi i interesit	1.3 herë	3 herë	1.2 herë	2 herë
Koeficientët e investitorve				
Fitimi për aksion	cent 0.9	euro 1.8	cent 0.75	euro 1.2
Dividenda për aksion	cent 0.2	cent 0.9	cent 0.25	cent 0.6

Kërkohet:

Drafto një raport për bordin e drejtorve, në emër të drejtorit financiar, që analizon performancën financiare të Rose sh.a duke vlerësuar secilën kategori të koeficientëve krahasuar me industrinë.

Total (20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 3

3.

Për: Bordin e Drejtorë

Nga: Chief Financial Officer

Data: 18 qeshor, 2016

Tema: Përformanca financiare dhe operative e Rose sh.a

Sipas kërkesës tuaj, unë kam analizuar përformancën financiare të Rose sh.a në raport me industrinë duke pasur parasysh mundësinë e ofertimit për blerje. Analizat e mia të secilës kategori të koeficientëve janë si në vijim:

Koeficientët e profitabilitetit

Koeficienti i fitimit bruto është afër vlerës më të lartë përderisa fitimi operativ është afër vlerës më të ulët krahasuar me kompanitë tjera. Kjo tregon që çështja kyqe që ndikon tek profitabiliteti i Rose sh.a është mungesa e kontrollit të shpenzimeve operative. Aspekti pozitiv i kësaj situatë është që në mund të jemi në gjendje të përmirësojmë profitabilitetin duke kontrolluar shpenzimet operative pa pasur nevojë të bëjmë shumë ndryshime në operacionet aktuale të sh.a.

Kthimi në ekuitetin e aksionarve është afër mesatarës që mbizotëron në industri. Ky koeficient është qartazi, i ndërlidhur me fitimin operativ siq u diskutua më sipër dhe mund të përmirësohet duke ushtruar kontroll më të madh ndaj shpenzimeve operative, pas blerjes.

Koeficientët e kapitalit qarkullues

Koeficientët e kapitalit qarkullues të Rose sh.a veçanërisht koeficienti i qarkullimit tregon që pozita e likuiditetit të kompanisë është e njëjtë me mesataren e industrisë. Andaj, duket se kapitali qarkullues i kompanisë është duke u menaxhuar në mënyrë të duhur edhe pse mund të ketë hapësirë për përmirësim.

Qarkullimi i stokeve është ndër më të ulët në industri gjë që tregon që ka politika të shëndosha të menaxhimit të stokeve. Megjithatë, niveli i të arkëtueshmeve është ndër më të lartat në industri. Shkaktarët e mundshëm të kësaj situatë mund të jenë si në vijim:

- Përpjekje të dobëta në arkëtim
- Mungesë të politikave të kontrollit kreditor apo mangësi të implementimit të tyre.
- Gjasat që ka borxhe të këqija të cilat nuk janë paraqitur.
- Shitje ndaj palëve të ndërlidhura.
- Shitje fiktive.

Duhet të kërkojmë shpjegime të duhura dhe investigojmë çështjet nëse është e mundur.

Koeficientët e leverazhit

Koeficienti borxh/ekuitet është në pjesën e lartë por mund të strukturohet pas blerjes. Megjithatë, mbulesa e interesit është vetëm 1.3. Është ndër më të ulëtat në industri dhe tregon një nivel të lartë të rrezikut pasi që fitimet mezi mbulojnë ngarkesat e interesit. Një rënie më e vogël në profitabilitet të kompanisë mund të ketë impakt negative në fitim neto të kompanisë.

Koeficientët e investitorve

Fitimi për aksion është në pjesën e ulët. Megjithatë, mund të përmirësohet duke ipërmirësuar fitimet siq u diskutua gjatë krahasimit të koeficientëve të përformancës operative. Pjesa e fitimeve të paguara si dividendë e Rose sh.a është më e ulëta (22.2%) shprehur në përqindje krahasuar me kompanitë e tjera të ngjajshme. Në përgjithësi, historia e kaluar e pagesave të dividendës nuk e

rëndësishme për vendimin tonë për blerje. Megjithatë dividendat e ulëta mund të jenë tregues i problemeve me likuiditet dhe duhet marrë parasysh këtë aspekt.

Konkluzion

Përformanca e kompanisë tregon një trend të përzier. Megjithatë, mund të konkludohet që performance nën mesataren, (aty ku është e aplikueshme) mund të përmirësohet duke rishikuar situatën dhe duke bërë ndryshimet e nevojshme në politika.

Problemi 4

a) Ju jeni Asistent i Kontabilitetit në Zeppelin sh.a. dhe ju janë dhënë informatat në vijim:

- Neto fitimi ishte €10,000,000
- Numri mesatar i ponderuara i aksioneve të zakonshme gjatë vitit ishte 12,000,000.
- Zeppelin sh.a kishte 10,000 obligacione me vlerë nominale prej €1,000 dhe normë të kuponit prej 10.0%. Secili obligacion është i konvertueshëm në 100 aksione të zakonshme.
- Zeppelin sh.a kishte gjithashtu 500,000 aksione preferenciale prej €10.00, të cilat paguajnë dividend prej 10.0%. Secili aksion preferencial mund të konvertohet në dy aksione të zakonshme.
- Zeppelin sh.a kishte gjithashtu 1,000 opcione të aksioneve, të cilat i lejonin mbajtësit të merrte 5 aksione të zakonshme. Çmimi i ushtrimit të të drejtës së opcionit është €12.00. Aksioni i zakonshëm i Zeppelin sh.a është aktualisht dhe ishte mesatarisht gjatë vitit duke u tregtuar me €11.00 për aksion dhe norma e tij e tatimit është 40%

Kërkohet:

Llogariteni fitimi bazik dhe të tretur për aksion të Zeppelin sh.a.

(10 pikë)

b) Në lidhje me secilën çështje më poshtë supozo që fundviti për raportim entitetit është 31 mars 2016

Çështja 1

Mustaine sh.a operon në një industri e cila shkakton kontaminim të mjedisit lokal. Operon në një vend ku nuk ka legjislacion të mjedisit. Entiteti ka publikuar në masë të madhe politikën e mjedisit sipas së cilës ndërmerr obligim për të pastruar të gjithë kontaminimin e shkaktuar.

Çështja 2

Cavalera sh.a një grup i kompanive farmaceutike ka vendosura me 24 mars 2016 që të mbyll një nga divizionet e saj. Kostot e vlerësuara të largimit të punëtorve të tepërt janë €40,000. Vendimi nuk i është komunikuar asnjërit nga të prekurit nga ky vendim dhe nuk janë ndërmarrë hapa tjerë para fundit të vitit për ta implementuar vendimin.

Çështja 3

Sipas legjislacionit të ri të aprovuar nga qeveria dhe që hyn në fuqi nga 30 qershor 2016 kompanitë e përfshira në djegjen e mbeturinave industriale janë të obliguara që t'i pajisin oxhaqet e tyre me filtra special. Dimebag sh.a vlerësoi me 25 mars 2016 që do t'i kushtoj €70,000 për t'i pajisur oxhaqet me filtra të tillë.

Çështja 4

Anselmo sh.a operon me fitim nga një fabrikë të cilën e ka marrë me qira me lizing operativ. Me 28 shkurt 2016 kompania u rilokua në një fabrikë më të madhe të ndërtuar për këtë punë. Lizingu në fabrikën e vjetër ende ka dy vite të mbetura dhe nuk mund të anulohet apo ti jipet dikujt tjetër me qira.

Kërkohet:

Diskuto duke iu referuar standardit përkatës trajtimin në kontabilitet të secilës nga çështjet më sipër.

(10 pikë)

Zgjidhja e Problemit 4

4. a)

Fitimi bazik për aksion llogaritet si në vijim:

$$= \text{€}10,000,000 / 12,000,000, \text{ ose } \text{€}0.833 \text{ për aksion}$$

Fitimi plotësisht i tretur për aksion llogaritet si në vijim:

$$\begin{aligned} \text{Fitimi i korigjuara} &= \text{€}10,000,000 + 500,000 \text{ aksione preferenciale} \times \text{€}10.00 \times 10\% + 10,000 \\ \text{obligacione} \times \text{€}1,000 \times 10.0\% \times (1 - 40\%) &= \text{€}10,000,000 + \text{€}500,000 + \text{€}600,000, \text{ or } \text{€}11,100,000 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \text{Aksionet e zakonshme të korigjuara} &= 12,000,000 + 500,000 \text{ aksione preferenciale} \times 2 + 10,000 \\ \text{obligacione} \times 100 &= 12,000,000 + 1,000,000 + 1,000,000, \text{ ose } 14,000,000 \text{ aksione} \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \text{Fitimi i tretur për aksion} &= \text{Fitimet e korigjuara} / \text{Aksionet e zakonshme të korigjuara} \\ &= \text{€}11,100,000 / 14,000,000, \text{ ose } \text{€}0.793 \text{ për aksion} \end{aligned}$$

b)

Duke iu referuar SNK 37

Çështja 1

Ngjarja obliguese është kontaminimi i mjedisit që shkakton pritshmëri valide të cilat rrjedhin nga politikat e publikuara të kompanisë që do të pastrojë mjedisin. Andaj entiteti duhet të njohë një provizion nëse shuma mund të matet me besueshmëri.

Çështja 2

Nuk ka ngjarje obliguese sa i përket largimit të puntorëve që nuk u është komunikuar apo pajtuar me të afektuarit. Nuk kërkohet provizion.

Çështja 3

Nuk ka ngjarje obliguese. Kompania mund të evitojë ndonjë kosto të përmirësimit për shembull duke shitur oxhaqet tek një palë e tretë para se legjislacionit të jetë efektiv. Nuk njihet provizion.

Çështja 4

Ngjarja obliguese është kontrata e lizingut. Kanë mbetur pagesa dy vjeçare në kontratë dhe nuk ka mundësi që të jipet me qira fabrika, kjo paraqet një kontratë që sjell humbje. Një provizion duhet të ndahet sipas vlerësimit më të mirë të pagesave të pashmangshme të lizingut.

Problemi 5

Kopshti sh.p.k së fundi ka zgjeruar operacionet e tij në prodhimin e mobiljeve për kopsht dhe shtëpive prej xhami. Më poshtë janë pasqyrat përkatëse.

<u>Pasqyra e Pozitës Financiare</u>	31 tetor 2015	31 tetor 2014
	€000	€000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Pasuritë themelore	791	450
Pasuritë e paprekshme	<u>12</u>	<u>17</u>
Total Pasuritë Jo-qarkulluese	803	467
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	62	44
Të arkëtueshmet tregtare	118	86
Interesi i arkëtueshëm	7	4
Investimet	25	12
Paraja	<u>8</u>	<u>20</u>
Total Pasuritë	1,023	633
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme 80 cent	232	200
Premia e aksioneve	86	70
Teprica e rivlerësimit	66	16
Fitimet e mbajtura	<u>189</u>	<u>152</u>
Total ekuiteti	573	438
<i>Detyrimet Afatgjata</i>		
10% Obligacione [të pagueshme 2016]	160	70
Lizingu Financiar	30	40
Tatimi i shtyrë	10	14
<i>Detyrimet Afatshkurtëra [shënim 1]</i>	<u>250</u>	<u>71</u>
Total Ekuiteti dhe Detyrimet	1,023	633

Ekstraket e Fitimeve të Mbajtura nga Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet.

	31 tetor 2015	31 tetor 2014
	€000	€000
Saldo në fillim e fitimeve	152	95
Fitimi për vitin	52	67
Dividenda e paguar	<u>(15)</u>	<u>(10)</u>
Total fitimet e mbajtura në fund të vitit	189	152

<u>Pasqyra e të ardhurave</u>	31 tetor 2015	31 tetor 2014
	€000	€000
Të hyrat	1,080	900
Kosto e shitjeve	<u>(756)</u>	<u>(540)</u>
Fitimi bruto	324	360
Shpenzimet operative	<u>(259)</u>	<u>(270)</u>
Fitimi operativ para interesit	65	90
Të hyrat nga interesi	14	-
Shpenzimet e interesit	<u>(19)</u>	<u>(13)</u>
Fitimi para tatimit	60	77
Tatimi në fitim	<u>(8)</u>	<u>(10)</u>
Fitimi për vitin	52	67

Informata shitesë:

i) Analiza e detyrimeve afatshkurtëra	31 tetor 2015	31 tetor 2014
	€000	€000
Të pagueshmet tregtare	124	44
Tatimi në fitim	13	8
Interesi i pagueshëm	10	7
Lizingu financiar	14	12
Mbitërheqja bankare	<u>89</u>	<u>0</u>
Total detyrimet afatshkurtëra	250	71
ii) Gjatë vitit kompania emetoi 40,000 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej €0.80 me një çmim prej €1.20. Tarifat ligjore dhe të kontabilitetit të paguara ishin €1,800 dhe janë trajtuar si shpenzime si pjesë e shpenzimeve operative.		
iii) Pasuritë themelore përfshijnë pronat të cilat janë rivlerësuar gjatë vitit dhe kanë shkaktuar një tepricë të rivlerësimit prej €50,000		
iv) Zhvlerësimi për vitin ishte €19,000		
v) Pasuritë e kapitalizuara nën Lizing Financiar gjatë vitit arritën shumën prej €41,000.		
vi) Një pasuri themelore me vlerë neto në libra prej €31,000 u shit për €18,000		
vii) Investimet janë blerë duke përdorur tepricën e përkohshme të parave dhe mund të shitën shumë afër vlerës së tyre të paraqitur sapo të lind nevoja për para.		

Kërkohet:

Përgadite pasqyrën e rrjedhës së parasë të Kopshti sh.p.k për vitin e përfunduar me 31 tetor 2015 në pajtim me SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parasë. (20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 5

5. Pasqyra e rrjedhës së parasë

	€
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative	
Fitimi para tatimit	60,000
Shto: Jo në para	
Zhvlerësimi	19,000
Kostot e emetimit të aksioneve	1,800
Humbja nga shitja e pasurisë (31,000 – 18,000)	13,000
Kostot financiare	19,000
Të hyrat nga investimet	(14,000)
Dëmtimi i pasurive të paprekshme (17,000 – 12,000)	<u>5,000</u>
Rrjedhat e parasë nga operacionet para ndryshimeve në kapitalin qarkullues	103,800
Rritja në stoqe (62,000 – 44,000)	(18,000)
Rritja në LI/A (118,000 – 86,000)	(32,000)
Rritja në LI/P tregtare (124,000 – 44,000)	<u>80,000</u>
Paraja e gjeneruar nga operacionet	133,800
Interesi i paguar (7,000 + 19,000 – 10,000)	(16,000)
Tatimi i paguar (II1)	(7,000)
Dividenda e paguar	<u>(15,000)</u>
Neto paraja nga aktivitetet operative	95,800
Rrjedhat e parasë nga aktivitete investuese	
Shitja e pasurisë themelore	18,000
Blerja e pasurive themelore (II2)	(300,000)
Interesi i arkëtuar (4,000 + 14,000 – 7,000)	<u>11,000</u>
	(271,000)
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese	
Emetimi i aksioneve minus kostot e emetimit (232,000 + 86,000 – 200,000 – 70,000 - 1,800)	46,200
Hyrjet nga borxhet afatgjata (160,000 – 70,000)	90,000
Ripagesat e kryegjëse së lizingut (LI3)	<u>(49,000)</u>
	87,200
	(88,000)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim (12,000 + 20,000)	32,000
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund (25,000 + 8,000 - 89,000)	(56,000)

Llogaritjet

L11

Tatimi			
Sal. fund (10,000 + 13,000)	23,000	Sal. fillestare (14,000 + 8,000)	22,000
Paraja (balancuese)	<u>7,000</u>	Fitimi dhe humbja	<u>8,000</u>
	30,000		30,000

L12

Pasuritë themelore			
Sal. fillim	450,000	Shitjet/largimet	31,000
Rivlerësuar	50,000	Zhvlerësimi	19,000
Lizingu Financiar	41,000		
Blerjet në para (balancuese)	<u>300,000</u>	Sal. fund	<u>791,000</u>
	841,000		841,000

L13

Lizingu Financiar			
Paraja (balancuese)	49,000	Sal. Fillim (40,000 + 12,000)	52,000
		Shtimet	<u>41,000</u>
Sal. fund (30,000 + 14,000)	<u>44,000</u>		
	93,000		93,000